



---

**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

**Nr.14, Datë 06.07.2017**

***“Për miratimin e tarifave të regjistrimit për programet e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2017-2018”***

Bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, neni 3, pika 3, gërma ç; neni 38, pika 1, gërma a, pika 3; neni 98, pika 2, gërma c; neni 109, pika 1, gërma b, në Statutin e UT neni 19, pika 2, si dhe në propozimet e njësisë kryesore, në mbledhjen e datës 06.07.2017, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2017-2018, si më poshtë:
  - Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve në shumën 1600 lekë.
  - Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në shumën 2500 lekë.
  - Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit në shumën 3000 lekë.
  - Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve në shumën 3000 lekë.
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit Tiranë.

**KRYETARI**

**PROF.DR.MYNYR KONI**